

URDHËR
Nr. 330, datë 10.4.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, ”Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të germës “c”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Ela Toçka, Përgjegjës i Sektorit të Apelimit, për sa vijon:
 - Për të trajtuar dhe nënshkruar aktet dalëse, kërkesës për informacion dhe dokumentacionin, lidhur me korrespondencën zyrtare me institucionet e varësisë të ASHK-së, në kuadër të trajtimit të kërkesë/ankesave pjesë e fushës së përgjegjësisë të Sektorit të Apelimit.
 2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, Përgjegjësi i Sektorit të Apelimit, nëse e gjykon të nevojshme, mund t’i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.
 3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.
 4. Në rast mungese në detyrë të Përgjegjësit të Sektorit të Apelimit, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, të Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.
 5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.
 6. Urdhri i drejtorit të përgjithshëm nr. 1196, datë 10.11.2025, shfuqizohet.
 7. Ngarkohet Sektori i Apelimit dhe znj. Ela Toçka, dhe Sektori i Arkiv Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli